

LIGJ
Nr.9894, datë 27.3.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE DHE TË PROTOKOLLIT TË SAJ PËR QARKULLIMIN NË ZONAT KUFITARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve dhe protokoli i saj për qarkullimin në zonat kufitare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5680, datë 31.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në emër të shteteve të tyre përkatëse, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”:

të nisura nga dëshira për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore që tashmë ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

duke konfirmuar se respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe parimeve të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe humanizmit përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes;

me synimin për të lehtësuar kontaktet e shtetasve me njëri-tjetrin si një instrument i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve dhe mbështetjes për zhvillim në të gjitha fushat e veprimtarisë;

të bindura se liria e lëvizjes njerëzore përbën një zhvillim themelor për forcimin e mëtejshëm të përpjekjeve të secilit vend për integrimin në Bashkimin Europian, janë marrë vesh si më poshtë:

Neni 1

1. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, të shërbimit ose pasaportave kombëtare do të përjashtohen nga detyrimi për t’u pajisur me vizë hyrëse në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një vizitë ose qëndrim jo më të gjatë se (90) ditë, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë)- ditëve nga data e hyrjes së parë.

2. Shtetasit e secilit vend do të hyjnë, do të kalojnë transit, do të qëndrojnë përkohësisht dhe do të largohen nga territori i Palës tjetër Kontraktuese në të gjitha pikat e kalimit kufitar të hapura për qarkullimin ndërkombëtar dhe ndërshtetëror, duke pasur një dokument të vlefshëm udhëtimi si ato që listohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Shtetasit e secilit vend do të hyjnë, do të kalojnë transit, do të qëndrojnë përkohësisht dhe

do të largohen nga territori i secilës Palë Kontraktuese pa taksa dhe tarifa për periudhën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

1. Shtetasit e Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, të lëshuara nga ministrinë e punëve të jashtme të Palëve Kontraktuese, mund të hyjnë, të kalojnë transit, të qëndrojnë dhe largohen nga territori i Palës tjetër Kontraktuese pa vizë, për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një periudhe 180 (njëqind e tetëdhjetë)- ditore nga data e hyrjes së parë.

2. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, të cilët janë pjesëtarë të stafit të një misioni diplomatik ose një posti konsullor, të një organizate ndërkombëtare, të një shërbimi tregtar dhe ekonomik brenda misionit diplomatik ose një qendër e informacionit kulturor, e krijuar mbi bazën e një marrëveshjeje ndërqeveritare, të cilat ndodhen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, fillimisht do të hyjnë në territorin e saj pa vizë. Pasi të jenë regjistruar në përputhje me procedurën e brendshme të Palës Kontraktuese pritëse, ata do të qëndrojnë pa vizë, deri në largimin e tyre nga territori i Palës Kontraktuese pritëse gjatë të gjithë periudhës së akreditimit të tyre.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni shtrihen deri te pjesëtarët e familjes së shtetasve në fjalë: bashkëshorti(ja), partneri civil, fëmijët nën moshën 26 vjeç, të cilët nuk kanë kryer martesë civile dhe që vazhdojnë mësimet me kohë të plotë në institucionet arsimore në territorin e Palës Kontraktuese pritëse dhe që jetojnë së bashku me ta gjatë mandatit të tyre në detyrë, nëse janë mbajtës të pasaportave diplomatike ose shërbimi.

4. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do zbatohen për personat që mbulon paragrafi 3, kur ata janë shtetas të një vendi të tretë, për të cilët Palët Kontraktuese zbatojnë regjimin e vizave. Në këtë rast, personat në fjalë do të pajisen me llojin përkatës të vizës që në hyrjen e tyre të parë në territorin e Palës Kontraktuese pritëse.

Neni 3

Qarkullimi në zonat kufitare ndërmjet Palëve Kontraktuese do të rregullohet nga protokolli i kësaj Marrëveshjeje, i cili do të jetë pjesë përbërëse e saj.

Neni 4

Shtetasit e Palëve Kontraktuese, të cilët dëshirojnë të qëndrojnë për periudha më të gjata kohore në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për qëllime studimi, punësimi, bashkimi familjar, etj., do t'u referohen dhe do të respektojnë dispozitat e legjislacionit të brendshëm të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 5

Në rast se për shkaqe të forcës madhore, një shtetas nuk ka mundësi për t'u larguar nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, atëherë brenda afatit të vlefshmërisë së qëndrimit, Pala Kontraktuese pritëse do ta bëjë falas zgjatjen e lejes së qëndrimit.

Neni 6

Shtetasit e Palëve Kontraktuese, që qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për periudha të shkurtra kohore, nuk do të kenë të drejtën e punësimit.

Neni 7

Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të veprojnë në përputhje me legjislacionin e kësaj të fundit.

Neni 8

Secila Palë Kontraktuese mund t'u refuzojë hyrjen ose të shpallë të pavlefshëm qëndrimin në territorin e saj të shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese, të cilët ajo, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, i gjykon si të papranueshëm ose të padëshirueshëm.

Neni 9

Kur shtetasit e Palës Kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese humbasin pasaportat e tyre ose dhe ndonjë dokument tjetër zëvendësues udhëtimi, ata do të njoftojnë menjëherë për këto raste autoritetet përkatëse vendore, të cilat nga ana e tyre do t'u lëshojnë një dokument njoftues ndihmës. Misioni diplomatik ose përfaqësia konsullore e shtetit të shtetësisë do t'i pajisë ata me një dokument të ri të përshtatshëm udhëtimi. Të dy këto dokumente, dokumenti i ri dhe ai njoftues duhet të paraqiten në pikat e kalimit kufitar.

Neni 10

1. Palët Kontraktuese do të këmbëjnë specimenet e pasaportave të tyre të vlefshme, nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur njëra Palë Kontraktuese lëshon një model të ri të dokumentit të udhëtimit apo i modifikon dokumentet tashmë të këmbëra, për këto modifikime duhet të njoftohet Pala tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike, 15 (pesëmbdhjetë) ditë përpara datës së hyrjes në qarkullim të dokumentit të ri ose të modifikuar. Ky njoftim duhet të përfshijë modelin e dokumenteve të reja ose të modifikuara dhe informacione mbi zbatueshmërinë e tyre.

Neni 11

1. Palët Kontraktuese do të krijojnë një komitet të përbashkët, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, i cili do të ketë për detyrë monitorimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që rrjedh nga interpretimi apo zbatimi i dispozitave të Marrëveshjes. Komiteti do të mbledhet sa herë që të jetë e nevojshme, me kërkesën e njëres prej Palëve Kontraktuese dhe të paktën dy herë në vit.

Neni 12

Kjo Marrëveshje dhe protokolli i saj mund të ndryshohen me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

1. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, veprimin e kësaj Marrëveshjeje, në rastin e një fatkeqësie natyrore, epidemie apo për shkak të konsideratave të sigurisë kombëtare dhe rendit publik, duke njoftuar menjëherë palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i veprimit të kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së këtij njoftimi.

2. Pala që ka marrë masat e treguara në paragrafin e mësipërm 1 të këtij neni do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër Kontraktuese për këtë shfuqizim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 14

1. Kjo Marrëveshje dhe protokolli i saj do të jenë të vlefshëm për një periudhë të papërcaktuar kohore; ato do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se janë përmbushur kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të përfundojë vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose

pjesëve të saj, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja ose pjesë të saj do të pushojnë së vepruari pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

3. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të pushojnë së vepruari Marrëveshja ndërmjet qeverisë maqedonase dhe qeverisë shqiptare për heqjen e kërkesave për vizë për pasaportat diplomatike e të shërbimit, si dhe tarifat për lëshimin e llojeve të tjera të vizave, e nënshkruar në Tiranë, më 4 dhjetor 1997, si dhe Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë maqedonase mbi rregullimin e qarkullimit në zonat kufitare të individëve me banim në zonat kufitare, nënshkruar në Tiranë, më 4 dhjetor 1997.

Bërë në Tiranë më 13.2.2008, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën: shqip, maqedonisht dhe anglisht, duke pasur secili nga tekstet fuqi të barabartë. Në rast të ndonjë paqartësie në interpretim, epërsi do të ketë teksti anglisht.

PROTOKOLL

I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE GJATË QARKULLIMIT NË ZONAT KUFITARE

Neni 1

Ky protokoll vendos regjimin e qarkullimit në zonat kufitare ndërmjet kufijve shtetërorë të dy vendeve, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”.

Neni 2

Për qëllime të këtij protokoll, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. “Kufi shtetëror” nënkupton një kufi të përbashkët ndërmjet të dy vendeve.
2. “Zonë kufitare” nënkupton një zonë në territorin e Palës Kontraktuese, e cila ndodhet jo më larg se 20 km nga vija kufitare. Njësitë vendore administrative brenda kësaj zone do të konsiderohen pjesë të zonës kufitare, ashtu siç tregohet në aneksin A. Në rast se ndonjë pjesë e kësaj njësie do të ndodhet mbi 20 km larg nga vija kufitare, por jo më larg se 25 km, ajo sërish do të konsiderohet si pjesë e zonës kufitare.
3. “Përfituesit” janë shtetasit e Palëve Kontraktuese, të cilët të paktën për një vit janë banues të ligjshëm në një zonë kufitare dhe që kanë të drejtë të pajisen dhe të përdorin një leje për qarkullim kufitar vendor.
4. “Leja për qarkullim kufitar” nënkupton një dokument të vlefshëm udhëtimi, i cili lejon përfituesin të kalojë kufirin shtetëror dhe të qëndrojë në zonën kufitare të Palës tjetër Kontraktuese, ashtu siç përcaktohet në këtë protokoll.
5. “Qarkullimi në zonat kufitare” është lëvizja e rregullt tej kufitare që kryhet nga përfituesit me qëllime udhëtimi ose qëndrimi në zonën kufitare të Palës tjetër Kontraktuese, për arsye kulturore, ekonomike ose familjare, për një periudhë të caktuar kohe, e cila përcaktohet në këtë protokoll.

Neni 3

1. Përfituesit që zotërojnë një leje të vlefshme për qarkullim në zonat kufitare mund të udhëtojnë dhe të qëndrojnë në zonën kufitare të Palës tjetër Kontraktuese deri në 7 (shtatë) ditë rresht.
2. Gjatë qëndrimit të tyre, që përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, përfituesit mund të merren me veprimtari fitimprurëse, duke përfshirë veprimtari ditore ose të përkohshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese.
3. Kohëzgjatja e përgjithshme e vizitave të tyre të radhës nuk duhet të jetë më e madhe se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.

Neni 4

1. Leja e qarkullimit në zonat kufitare lëshohet nga një autoritet kompetent shtetëror i Palës Kontraktuese, mbështetur në kërkesën e miratuar nga autoritetet kompetente policore kufitare vendore të Palës tjetër Kontraktuese, brenda 5 (pesë) ditëve punë.

2. Leja jepet me një vlefshmëri kohore prej 5 vjetësh.

3. Leja përmban:

a) fotografinë e kërkuesit (me ngjyra) jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj, emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe vendbanimin;

b) autoritetin lëshues, datën e lëshimit dhe vlefshmërinë;

c) numrin e dokumentit mbi bazën e të cilit përcaktohet identiteti i kërkuesit;

d) data dhe fotografia e fëmijve nën 14 (katërmëdhjetë) vjeç të përfituesit të lejes;

e) shpjegimin se zotëruesi i lejes mund të lëvizë lirisht vetëm në zonën kufitare dhe se në rastin e keqpërdorimit do të ketë sanksione.

4. Leja do të përfshijë, sa më shpejt që të jetë e mundur, karakteristikat mbrojtëse në pajtim me standardet e BE-së.

Neni 5

1. Palët Kontraktuese mund të heqin dorë nga detyrimi për të vendosur në leje vula hyrëse dhe dalëse.

2. Për qëllime të evidencimit të hyrjes, daljes dhe qëndrimit, autoritetet e pikave të kalimit kufitar të Palës Kontraktuese, sipas rastit, mund t'u lëshojnë përfituesve një dëshmi të veçantë, në të cilën do të shënohen data, vendi dhe pika e kalimit kufitar ku është bërë kalimi i kufirit shtetëror.

Neni 6

Palët Kontraktuese do të marrin në vazhdimësi masat e duhura për lehtësimin e kalimit të kufirit shtetëror. Këto masa do të përfshijnë:

a) krijimin e pikave të veçanta të kalimit kufitar, vetëm për përfituesit, në përputhje me legjislacionin kombëtar;

b) rezervimin e linjave të veçanta për përfituesit në pikat e kalimit kufitar ndërkombëtar;

c) mundësimin e përfituesve, sa herë që të jetë e nevojshme dhe në veçanti duke mbajtur parasysh rrethanat vendore, duke përfshirë dhe rastet e forcës madhore për të kaluar kufirin në vende ku nuk ka pika të kalimit kufitar dhe/ose jashtë orarit të shpallur të punës;

d) përfituesit që njihen nga oficerët e policisë kufitare për shkak të kalimit të tyre të shpeshtë të kufirit, sa herë që të jetë e nevojshme, mund t'u nënshtrohen kontrolleve rutinore.

Neni 7

Përfituesit e secilës Palë Kontraktuese, që gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese humbasin lejen, duhet të njoftojnë për këtë rast menjëherë autoritetet e policisë vendore, të cilat do të lëshojnë një dokument njoftimi ndihmës. Ky dokument njoftues duhet të paraqitet në pikën e kalimit kufitar.

Neni 8

Ky protokoll do të zbatohet në të gjitha pikat e tanishme dhe të ardhshme të kalimit kufitar ndërkombëtar, si dhe në pikat vendore të kalimit kufitar, duke përfshirë edhe linjën e udhëtarëve të liqenit. Lista e të gjitha pikave të kalimit kufitar tregohet në aneksin B.

Neni 9

1. Përfituesit nuk mund të udhëtojnë apo të qëndrojnë jashtë zonës kufitare të përcaktuar në këtë protokoll.

2. Mosrespektimi i kësaj dispozite do të konsiderohet qëndrim i paligjshëm dhe do t'u nënshtrohet masave të duhura në pajtim me legjislacionin kombëtar të secilës Palë Kontraktuese. Kjo mund të përfshijë edhe anulimin e lejes nga autoriteti lëshues, për një periudhë kohore prej jo më pak se një vit.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë rregullisht informacion mujor mbi përfituesit, që janë objekt i masave në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

Bërë në Tiranë më 19.2.2008, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, maqedonisht dhe anglisht, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në rast të ndonjë paqartësie në interpretim, epërsi do të ketë teksti anglisht.

ANEKSI A
LISTA E NJËSIVE LOKALE ADMINISTRATIVE NË ZONËN KUFITARE
(SH. N.2 P. 2)

LISTA E FSHATRAVE SHQIPTARE

Rrethi Dibër:

I. Qyteti Peshkopi

II. Komuna Maqellarë:

1. Maqellarë
2. Pocest
3. Katund i Vogël (Obok)
4. Kërçisht i Poshtëm
5. Kërçisht i Sipërm
6. Kllobçisht
7. Bllatë e Sipërme
8. Bllatë e Poshtme
9. Majtare
10. Burim
11. Potgorcë
12. Çernene
13. Fushë e vogël
14. Kovashicë
15. Gradec
16. Pesjakë
17. Grazhdan
18. Popinare
19. Herbel
20. Erebarë
21. Dovolani
22. Vojnikë

III. Komuna Melan:

1. Melan
2. Trepçe
3. Pjeçe
4. Pejk
5. Trene
6. Illicë
7. Begjunec
8. Rabdisht
9. Bellovë
10. Zagrad
11. Cerjan

12. Grevë

IV. Komuna Tomin:

1. Tomin
2. Pollozhan
3. Çetush
4. Dohoshisht
5. Selane
6. Ushtelenxë
7. Brezhdan Zdojan
8. Rashnapojë
9. Pilafë
10. Staravec
11. Shimçan
12. Bahute
13. Zimur
14. Hotesht

V. Komuna Sllovë:

1. Shumbat
2. Sllovë
3. Dipjake
4. Venisht
5. Palaman
6. Trojak
7. Sllatinë
8. Kalis (Zallkalis)
9. Vleshë
10. Kalle

VI. Komuna Kala e Dodës:

1. Vasie
2. Ploshtan
3. Ceren
4. Kullas
5. Shulla
6. Ujëmirë
7. Tejse
8. Radomirë

VI. Komuna Kastriot:

1. Vrenjt
2. Limjan
3. Sohodoll
4. Deshat
5. Borovjan
6. Brest i Epërm
7. Brest i Poshtëm
8. Kander
9. Kishavec
10. Vakuf
11. Kastriot
12. Fushë-Kastriot
13. Kukaj

Rrethi i Bulqizës:

I. Komuna Shupenzë

1. Shupenzë
2. Vlashaj
3. Boçeve
4. Homesh
5. Kovashicë
6. Okshatinë
7. Zogjaj
8. Bllacë
9. Stushaj
10. Gjuras
11. Mazhicë
12. Topojan

II. Komuna Gjoricë:

1. Gjoricë e Sipërme
2. Gjoricë e Poshtme
3. Çerenec i Sipërm
4. Çerenec i Poshtëm
5. Lubalesh
6. Viçisht i Sipërm
7. Viçisht i Poshtëm

III. Komuna Zerqan:

1. Zerqan
2. Valikardhe
3. Peladhi
4. Godvi
5. Krajke
6. Sofraçan
7. Strikçan
8. Sopot
9. Zall Sopot
10. Smollnik
11. Ternovë e Madhe
12. Ternovë e Vogël
13. Zall Strikçan

IV Komuna Ostren:

1. Ostren i Madh
2. Ostren i Vogël
3. Tuçep
4. Radovesh
5. Pasinke
6. Lladomericë
7. Tërbaç
8. Kojavec
9. Lejçan
10. Mireshe
11. Sepatov
12. Okshtun i Madh
13. Okshtun i Vogël
14. Oreshnje
15. Orzhanov

V. Komuna Trebisht:

1. Trebisht
2. Trebjsht Bala
3. Trebisht Muçine
4. Trebisht Çelebi
5. Vernice
6. Gjinovec
7. Klenje

Rrethi i Librazhdit :

I. Bashkia Prrenjas:

1. Prenjas
2. Prenjas fshat
3. Rashta

II. Komuna Rrajcë:

1. Rrajcë
2. Rrajcë Fushë
3. Rrajcë Sutaj
4. Rrajcë Skënderbe
5. Bardhaj
6. Kovanik
7. Urakë
8. Katjel
9. Kotodesh

III. Komuna Qukës:

1. Qukës
2. Qukës Shkumbin
3. Qukës Skënderbe
4. Skroskë
5. Mënik
6. Pishkash
7. Pishkash Veri
8. Kakavec
9. Gurrë
10. Berzershte
11. Fanje
12. Dritaj

V. Komuna Hotolisht:

1. Hotolisht
2. Vulçan
3. Dadhë
4. Kokreve
5. Xhyrë
6. Velçan

V. Komuna Qendër:

1. Librazhd qendër
2. Librazhd katund
3. Gizavesh
4. Qarrishtë
3. Dorëz
6. Togëz
7. Arrëz

8. Babje
9. Spathar
10. Dragostun
11. Kuterman
12. Marinaj
13. Merqizë

VI. Komuna Steblevë:

1. Steblevë
2. Fushë studen
3. Zabzun
4. Borovë
5. Llange
6. Sebisht
7. Moglicë
8. Prodan

VII. Komuna Lumik:

1. Lunik
2. Zgosht
3. Letem
4. Kosharisht
5. Prevalle
6. Dranavice
7. Kodstenje

Rrethi i Pogradecit

Qyteti Pogradec

I. Komuna Buçimas (Starovë):

1. Buçimas (Starovë)
2. Tushemisht
3. Gurras (Zagorçan)
4. Remenj
5. Gështenjas (Zervaske)
6. Verdove
7. Baçallek
8. Peshkepi

II. Komuna Hudenisht:

1. Fshati Hudenisht
2. Memelisht
3. Piskupat
4. Buqezë
5. Lin
6. Çervenakë

IV Komuna Çerrave:

1. Fshati Çerrave
2. Leshnicë
3. Blacë
4. Alarup
5. Bletas (Bratomir)
6. Pretushe
7. Grabovicë
8. Nizhavec

V. Komuna Proptisht:

1. Fshati Proptisht
2. Verri
3. Golik
4. Zall - Torr
5. Rrodokal Super
6. Rrodokal
7. Poshtë
8. Homesh
9. Kriçkovë
10. Homçan
11. Somotinë
12. Slatinë
13. Baribardhe
14. Selcë e Poshtme

VI. Komuna e Beragozhd:

1. Fshati Beragozhd
2. Stropcke

VII. Komuna Trebinjë:

1. Fshati Trebinjë
2. Pleshisht
3. Zemçe
4. Hoshtece
5. Selcë e Sipërme
6. Kalivaç
7. Pervelan
8. Potgozha
9. Dunicë

Rrethi i Korçës

I. Komuna i Liqenas:

1. Goricë e madhe
2. Kallamas
3. Goricë e vogël
4. Gollomboc
5. Diellas
6. Liqenas
7. Zaroshke
8. Cerje
9. Lajthizë
10. Leskaj

I. Komuna Polan:

1. Burimas
2. Zvezde
3. Shingjergj
4. Pojan
5. Pendavinj
6. Terovë
7. Plasë
8. Zemblak
9. Rembec
10. Rov

11. Orman
12. Pojan

III. Komuna Bulgarec:

1. Dishnicë
2. Belorta
3. Kuç i Zi
4. Neviçisht
5. Malavec
6. Shamoll

LISTA E FSHATRAVE MAQEDONASE

ОА ШГЗ=!Г э?ЕГЗ%!Х

1. $\text{rp}\forall^* \text{эocH4}\&\forall\Delta$
2. $\Phi,;\equiv \# \text{po}^*,\Pi$
3. $\Phi,;\equiv \# \text{or}^*,\&\text{o}$
4. $\Phi,;\equiv \text{Kpa8}\equiv \text{p}>\Pi\alpha$
5. $\Phi,;\equiv \text{Ta}>\text{yTe}$
6. $\Phi,;\equiv \text{э}\Delta\text{e8}\forall\text{j}$
7. $\Phi,;\equiv \text{H4}\&\text{4THe}$
8. $\Phi,;\equiv \#4\exists\text{aj}$
9. $\Phi,;\equiv \text{H4cH}\Delta\equiv\&\equiv$
10. $\Phi,;\equiv \text{X4}\exists>\text{4}\Pi\forall$
11. $\Phi,;\equiv \%4*\text{9T},$
12. $\Phi,;\equiv /4\Delta\equiv\&>\text{4}\Pi\forall$
13. $\Phi,;\equiv \text{B}\Delta\exists\text{ja},$
14. $\Phi,;\equiv \#4\text{H9T},$
15. $\Phi,;\equiv \Gamma\Delta,\exists4\text{TH},$
16. $\Phi,;\equiv \%,;,\exists\Delta^*\equiv$
17. $\Phi,;\equiv \text{E89}^*\Delta4$,
18. $\Phi,;\equiv \text{X}\equiv\Phi\text{H9T},$
19. $\Phi,;\equiv !\heartsuit4,\&\Pi4$
20. $\Phi,;\equiv \text{A}\Delta4\Phi\equiv\Box>\text{4}\Pi\forall$
21. $\Phi,;\equiv /90$,
22. $\Phi,;\equiv =4\text{PB9}\Delta$
23. $\Phi,;\equiv \% \Delta\exists,>$
24. $\Phi,;\equiv \% \equiv:8\equiv\&4\Box\forall$
25. $\Phi,;\equiv \Gamma\Delta4\Pi\forall$
26. $\Phi,;\equiv ;\forall\&\Delta\equiv\&4 !>\equiv\&4$
27. $\Phi,;\equiv 74\text{P}>\text{4}\Pi\forall$
28. $\Phi,;\equiv \#,;4\text{P4}\Pi\forall$
29. $\Phi,;\equiv =484\Delta\equiv\Delta\equiv\&\equiv$
30. $\Phi,;\equiv \text{э}\forall:4\text{P}>48$
31. $\Phi,;\equiv \Box\forall>\text{P},$
32. $\Phi,;\equiv \text{E},;\Pi,$
33. $\Phi,;\equiv \text{X}\equiv\Phi\equiv84$
34. $\Phi,;\equiv \text{э}\forall\Delta4$
35. $\Phi,;\equiv \Gamma\Delta,\Phi\equiv>\text{P},$
36. $\Phi,;\equiv)\forall2\forall\Delta\equiv\text{B}\equiv\text{B},$

?AΣΓЗ=!)+#!X

1. $\text{rp}\forall^*)\exists\forall\Delta$
2. $\Phi,;\equiv +^*,\&\Pi4$

3. $\Phi, \vdash \vdash (\forall T$
4. $\Phi, \vdash \vdash \& \forall 8$
5. $\Phi, \vdash \vdash 7 \vdash \heartsuit \forall \heartsuit 48$
6. $\Phi, \vdash \vdash \# \Delta, TH \forall > 4$
7. $\Phi, \vdash \vdash \spadesuit, B4TH,$
8. $\Phi, \vdash \vdash E \forall \exists \vdash H4T \forall > 4$
9. $\Phi, \vdash \vdash A \Delta \forall :, > 48$
10. $\Phi, \vdash \vdash /4H4 > \forall > 4$
11. $\Phi, \vdash \vdash ; \forall: A \forall B \Delta \forall H > 48$
12. $\Phi, \vdash \vdash \exists \vdash, < A \forall B \Delta \forall H > 48$
13. $\Phi, \vdash \vdash \# \forall: \forall > \Pi 4$
14. $\Phi, \vdash \vdash ? B \Phi \forall \Pi 4$
15. $\Phi, \vdash \vdash \# \forall \square \Delta \forall \leq \& \Pi 4$
16. $\Phi, \vdash \vdash \# \Delta \vdash TH4 \Pi \forall$
17. $\Phi, \vdash \vdash \spadesuit \forall \Delta, T4$
18. $\Phi, \vdash \vdash \exists \vdash \Delta, > \Pi 4$
19. $\Phi, \vdash \vdash E, \vdash 89 \square 4$
20. $\Phi, \vdash \vdash E B \forall \Phi$
21. $\Phi, \vdash \vdash \# \forall \quad 4TH,$
22. $\Phi, \vdash \vdash M \forall < ,$
23. $\Phi, \vdash \vdash 7 \Delta 4 \& \Pi 4$
24. $\Phi, \vdash \vdash X \forall \square P4 \Pi \forall$
25. $\Phi, \vdash \vdash \Gamma \forall H \forall \Delta$
26. $\Phi, \vdash \vdash +: \& \Pi 4$
27. $\Phi, \vdash \vdash ; \vdash (\equiv \Delta P,$
28. $\Phi, \vdash \vdash ? \Phi \vdash \square$
29. $\Phi, \vdash \vdash \exists \vdash \Delta > \vdash 7 \vdash \Phi \vdash \& \Delta \forall \Phi H4$
30. $\Phi, \vdash \vdash) \vdash: > \vdash 7 \vdash \Phi \vdash \& \Delta \forall \Phi H4$
31. $\Phi, \vdash \vdash \exists, ;, : > 4P \forall > 4$
32. $\Phi, \vdash \vdash), ;, : > 4P \forall > 4$
33. $\Phi, \vdash \vdash \# \forall B \forall$
34. $\Phi, \vdash \vdash \Sigma 9 \forall >$
35. $c, \vdash \vdash 7 \vdash \quad \forall \Delta,$
36. $\Phi, \vdash \vdash \# \vdash < \vdash \& \vdash$
37. $\Phi, \vdash \vdash + N: \vdash, \Pi$

?AΣΓ3=! ΕΓΧΙδ!

1. $\Phi, \vdash \vdash E H \Delta 9 (\forall$
2. $\Phi, \vdash \vdash X \forall * \vdash 0 * \forall$
3. $\Phi, \vdash \vdash 7 \forall: 4TH \forall$
4. $\Phi, \vdash \vdash ; \forall: 4 \%: \forall \square$
5. $\Phi, \vdash \vdash K \Delta \forall > (\equiv \& \vdash$
6. $\Phi, \vdash \vdash X \forall * \vdash: 4TH \forall$
7. $\Phi, \vdash \vdash \Sigma 9 <$
8. $\Phi, \vdash \vdash 1 \forall (\forall \Delta \forall P \forall > 4$
9. $\Phi, \vdash \vdash \% 4T > 4$
10. $\Phi, \vdash \vdash \exists \vdash \Delta > \forall \#, : 4 \Pi \forall$
11. $\Phi, \vdash \vdash) \vdash: > \forall \#, : 4 \Pi \forall$
12. $\Phi, \vdash \vdash ? 8H4 \Phi 4$
13. $\Phi, \vdash \vdash \%, \& P \forall > 4$
14. $\Phi, \vdash \vdash \%, :, TH \forall$
15. $\Phi, \vdash \vdash \% \Delta \forall > 4TH \forall$

16. $\Phi, \vdash A \equiv * (\equiv \Delta \Pi 4$
17. $\Phi, \vdash 9 \forall \exists 9 > 4 \text{TH} \forall$
18. $\Phi, \vdash \# \equiv \Delta \equiv \&, \Pi$
19. $\Phi, \vdash 9 \forall 8 \forall \& 4 \Pi \forall$
20. $\Phi, \vdash \square \forall \exists : \forall > 4 \Pi \forall$
21. $\Phi, \vdash A 4 \Phi 8 9 \text{BTH} 4 > \forall$
22. $\Phi, \vdash \# \Delta, 2 \equiv \& \equiv$
23. $\Phi, \vdash =, \Delta, 2 4$
24. $\Phi, \vdash 9 9 8 \equiv \& \equiv$
25. $\Phi, \vdash ; \equiv * \Delta 4 \text{P}$
26. $\Phi, \vdash) \Delta, > \equiv 8$
27. $\Phi, \vdash \# 9 \Delta 4 >, \Pi$
28. $\Phi, \vdash E, : \Pi 4$
29. $\Phi, \vdash 9 \equiv 8 \equiv \&$
30. $\Phi, \vdash X 0 \forall > \equiv \& \equiv$
31. $\Phi, \vdash 1 \exists \forall 0 * 4$
32. $\Phi, \vdash A \Delta 4 \Phi \equiv \& \square \forall > 4$
33. $\Phi, \vdash ; 4 \Phi : \equiv *, 0 * \forall$
34. $\Phi, \vdash \# \Delta \text{P}, \& \equiv$
35. $\Phi, \vdash \# \equiv (\equiv \square \Pi 4$
36. $\Phi, \vdash \Gamma \forall \text{H}, 0 4$
37. $\Phi, \vdash \Gamma \forall \text{T} < \forall \Delta 9 > 4 \text{TH} \forall$
38. $\Phi, \vdash), \vdash (\equiv 0 * \forall$
39. $\Phi, \vdash 7 \equiv \Delta \equiv \text{T} 4 \text{TH} \forall$
40. $\Phi, \vdash \blacklozenge, \text{B} 4 >$
41. $\Phi, \vdash \# 4 \heartsuit, \& \equiv$
42. $\Phi, \vdash 9 \equiv 0 \forall > 4$
43. $\Phi, \vdash 9 4 \& \forall * \forall$
44. $\Phi, \vdash \% \equiv : 4 > \equiv$
45. $\Phi, \vdash) \Delta \Phi : \forall \square \Pi \forall$
46. $\Phi, \vdash ; \equiv \Delta \equiv 4 \text{TH} \forall$
47. $\Phi, \vdash ; 4 \Phi :, \text{T}, \& \equiv$
48. $\Phi, \vdash A \equiv 9 <$

?AΣΓ3=! ?MX3)

1. $\Phi, \vdash ? \text{N} \Delta 4 *$
2. $\Phi, \vdash + : \text{T} \forall > 4$
3. $\Phi, \vdash A, \text{TH} \forall > 4$
4. $\Phi, \vdash \Gamma \Delta \text{B}, \square \Pi \forall$
5. $\Phi, \vdash \square 9 \exists \forall > 4 \text{TH} \forall$
6. $\Phi, \vdash \exists \equiv \Delta > \equiv 9 \forall 8 \equiv \text{P}, \Delta, \square$
7. $\Phi, \vdash) \equiv : > \equiv 9 \forall 8 \equiv \text{P}, \Delta, \square$
8. $\Phi, \vdash A \equiv * < \equiv \square,$
9. $\Phi, \vdash ? \Delta < \forall >$
10. $\Phi, \vdash 9, \Phi 8 \equiv, \Pi$
11. $\Phi, \vdash \%, : (\equiv \text{TH} 4$
12. $\Phi, \vdash \%, :, \Phi \text{H} \equiv \& \equiv$
13. $\Phi, \vdash X \forall < >,$
14. $\Phi, \vdash 7 \equiv \square \Phi 8 \equiv$
15. $\Phi, \vdash \Sigma 4 \text{B} \equiv 8 > \equiv$

?AΣΓ3=! X+E+=

1. $\Phi, \vdash X, \Phi, >$
2. $\Phi, \vdash 7 \equiv \square \Phi 8 \equiv$
3. $\Phi, \vdash EH, \square,$
4. $\Phi, \vdash 9, \Phi 8 \equiv, \Pi$
5. $\Phi, \vdash ?H, T, \& \equiv$
6. $\Phi, \vdash \forall \Phi, \exists \forall E 4 \Delta N \forall >$
7. $\Phi, \vdash \Sigma 9 \Delta, > \Pi 4$
8. $\Phi, \vdash \% \equiv : 8 \equiv *, \Delta 4$
9. $\Phi, \vdash A \equiv 8 \Delta \&, > 4 8$
10. $\Phi, \vdash) \equiv : > \equiv A, \Delta \equiv \& \equiv$
11. $\Phi, \vdash = \forall 8 \equiv :, \Pi$
12. $\Phi, \vdash E : 4 \& > 4 \Pi \forall$
13. $\Phi, \vdash A \Delta, H \equiv \Delta$
14. $\Phi, \vdash ! \Phi \forall < \forall H 4$
15. $\Phi, \vdash + \& : \forall$
16. $\Phi, \vdash A \Delta, \square 9 \exists \square,$
17. $\Phi, \vdash 9 \forall \& \Pi 4$
18. $\Phi, \vdash \exists \equiv \Delta > \equiv) 9 B, > 4$
19. $\Phi, \vdash \exists \equiv \Delta > \equiv A, \Delta \equiv \& \equiv$
20. $\Phi, \vdash) \Delta <, > 4$
21. $\Phi, \vdash O \forall \Delta, \&) \& \equiv \Delta$
22. $\Phi, \vdash 7 \equiv 2 \square \forall 8$
23. $\Phi, \vdash \#, : \forall O \Delta 8 \& \forall$
24. $\Phi, \vdash) \equiv : > \equiv + 2, \Delta, > 4$
25. $\Phi, \vdash \exists \equiv \Delta > \equiv + 2, \Delta, > 4$
26. $\Phi, \vdash \exists \Delta > P \forall \Delta 4$
27. $\Phi, \vdash X \forall \square \Pi \forall$
28. $\Phi, \vdash 7 9 \Delta \exists 4 > \equiv \& \equiv$
29. $\Phi, \vdash ; \forall : \equiv \& 4 T H,$
30. $\Phi, \vdash) \equiv : > \equiv) 9 B, > 4$
31. $\Phi, \vdash \square 9 \exists \equiv \square > \equiv$
32. $\Phi, \vdash \# \Delta \forall \square P 4 > \equiv$
33. $\Phi, \vdash \Sigma H \Delta \exists \equiv \& \equiv$
34. $\Phi, \vdash 7 \Delta \forall > 4$
35. $\Phi, \vdash ! \Delta \& \forall H 4$

$A \Sigma \Gamma 3 = !) + \# ! X O !$

1. $\Phi, \vdash \% \Delta \exists \square \forall > 4$
2. $\Phi, \vdash \exists \equiv * 4 \& \square,$
3. $\Phi, \vdash 9 \forall 8 H 4 \square,$
4. $\Phi, \vdash 7 : 4 <, T H \forall > 4$
5. $\Phi, \vdash = \equiv \& \equiv E, : \equiv$
6. $\Phi, \vdash \Gamma \Delta, \exists, > 4 T H \forall$
7. $\Phi, \vdash ? \Delta \equiv \& > 4 8$
8. $\Phi, \vdash \exists \equiv \Delta, > \Pi 4$

ANEKSI B

LISTA E KALIMEVE KUFITARE PËR QARKULLIM NË ZONAT KUFITARE
(SH. N.8)

Për Republikën e Shqipërisë

Për Republikën e Maqedonisë

Kalime kufitare në përdorim

1. Qafëthanë, Pogradec $7\forall K\forall\Phi\forall>EH\Delta9(\forall$
2. Tushemisht, Pogradec $E\&,H4=\forall9<, ?N\Delta4*$
3. Goricë, Liqenas $EH,\square,, A\Delta,\Phi B\forall$
4. Bllad, Maqellarë $\#:\forall H\cong,),\exists\forall\Delta$

Kalime kufitare për përdorim në të ardhmen

1. Trebisht, Bulqizë $\blacklozenge,B4TH,),\exists\forall\Delta$
2. Steblevë, Librazhd $\square\forall\exists:\forall>4\Pi\forall, 998\cong\&\cong$
3. Miresh, Librazhd $\Sigma B4\square,,),\exists\forall\Delta$

Linjat ndërkombëtare të udhëtarëve të liqenit

1. Pogradec $?N\Delta4*$
2. Liqenas $X,\Phi,>$